VENDIM
Nr. 49, datë 5.8.2020

PËR MIRATIMIN E MBYLLJES SË FAZUAR TË AKTIVITETIT TË NDËRMJETËSIMIT TË INVESTIMIT TË PERSONAVE FIZIKË NË BONO THESARI NËPËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronjat "b" dhe "ç", si dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbyllë aktivitetin e ndërmjetësimit të investimit të personave fizikë në bono thesari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, sipas fazave në vijim:

a) Në datën 1 janar 2021 të ndërpritet lidhja e kontratave të reja për pjesëmarrjen e tërthortë të personave fizikë në sistemin AFISaR;

b) Në datën 1 janar 2022 të ndërpritet ndërmjetësimi i investimit në bono thesari nga personat fizikë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë.

2. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe Departamenti i Emisionit i Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko